



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 12.2 pika d) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/4 qershor 2008), nenit 38 nënparagrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-53125 date 11 nëntor 2011 dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 35/17 dhjetor 2012) dhe nenit 5 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës datë 21.10.2013, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me datë 19.03.2014, miraton këtë:

VENDIM

Paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës

1. Kuvendi i Komunës së Gjilanit **Aprovon** propozimin e Kryetarit të Komunës për miratim paraparak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës së Gjilanit si në vijim (**neni 7 i Ligjit nr.04/L-144 dhe neni 5 par.1 dhe 2 i Rregullores QRK nr.23/2013**) :

PARKINGJET :

- 1.1. Lokacioni të ish objekti i Higjienës, ngastrat kadastrale nr. 3878-0 me sipërfaqe prej 1013m² dhe 3872-0 me sipërfaqe prej 1018 m²;
- 1.2. lokacioni të ish objekti i Magjistrales të Stacioni i Autobusëve, ngastra kadastrale, nr. 2438-1 me sipërfaqe prej 1600 m²;
- 1.3. lokacioni tek ish objekti i Kadastrit me qira, ngastra kadastrale nr. 3765-0 me sipërfaqe prej 2491m²;
- 1.4. lokacioni tek rruga “15 Qershori”, të shkolla fillore “Selami Hallaqi”, ngastra kadastrale nr. 4776-0 me sipërfaqe prej 7060 m²;
- 1.5. lokacioni tek rruga “Isa Boletini”, të zjarrfikësit, ngastra kadastrale nr. 2713-0 me sipërfaqe prej 12014 m², ngastra kadastrale nr. 4720-0 me sipërfaqe prej 721m² dhe ngastra kadastrale nr. 4670-0 me sipërfaqe prej 1287m²;
- 1.6. lokacioni tek rruga “Xhemajl Mustafa” të parku i qytetit, ngastra kadastrale 4507-0 me sipërfaqe prej 2932 m²;
- 1.7. lokacioni tek QKMF-ja, dhe para objektit të NTP “CIRI”, ngastrat kadastrale nr. 3539-0 me sipërfaqe prej 1883 m² dhe 3602-0 me sipërfaqe prej 3400 m²;
- 1.8. lokacioni përball shkollës së Mesme Teknike “Mehmet Isai”, ngastra kadastrale nr. 4767-0, me sipërfaqe prej 14122m².
- 1.9. lokacioni tek rruga “Haqif Tetova”, të Posta e Vogël në Lagjen “Dardania”, ngastra kadastrale 3258-0 me sipërfaqe prej 9206 m². **(të definohet saktë sipërfaqja e dedikuar për parkingje në ngastrat kadastrale të cekura nga pika 1.1 deri në pikën 1.9 të këtij vendimi).**

LOKALET AFARISTE :

- 1.10. lokali afarist përball objektit të “Ipkos” ngastra kadastrale nr. 3671-0 me sipërfaqe afariste prej 82 m²;
- 1.11. lokalet afariste përball objektit të “Ipkos” ngastrat kadastrale nr. 3672-0 me sipërfaqe afariste njeri lokal 18 m² dhe 17m²;
- 1.12. lokalet afariste në objektin e ish “Teknikes popullore”, ngastra kadastrale nr. 3429-2, njeri lokal 19 m² tjetri 45 m² dhe i treti, 32.40m²;
- 1.13. lokali afarist të “Qendra Zejtare”, ngastra kadastrale 3687-0 me sipërfaqe 18 m²;
- 1.14. lokali afarist ish Kooperativa Zejtare e Berberëve, ngastra kadastrale 3756-0-28-2-3-0, me sipërfaqe afariste prej 29 m²;
- 1.15. Bodrumi në ndërtesën përballë Xhamisë së Madhe, rr. “ A.Jashari”, (ish- Tombolla), ngastra kadastrale 3662-0 me sipërfaqe prej 2833 m², sipërfaqja afariste prej 110 m²,
- 1.16. Objekti i ngrohtores – depoja në Lagjën Iliria (ish-Kamnik) me sipërfaqe prej 360 m² .

LOKALET AFARISTE- BARAKAT (KIOSQET):

- 1.17. 22 lokale afariste të Qendra Tregtare Zejtare- Argjendaria, rruga “Shatërvani”, prapa Xhamisë së Madhe, me sipërfaqe nga 9m² secili lokal.

HAPËSIRAT PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE REKLAMUESE :

- 1.18. Hapsirat për vendosjen e objekteve reklamuese, billbordeve të cilat gjenden në ngastrat kadastrale 2704-0, me sipërfaqe prej 16921 m², 2143-0 me sipërfaqe prej 804 m², ngastra kadastrale 3610-0 me sipërfaqe prej 2307 m², ngastra kadastrale 4779-1 me sipërfaqe prej 4294 m², ngastra kadastrale 4779-2 me sipërfaqe prej 8713 m², ngastra kadastrale 2710-0 me sipërfaqe prej 20996 m², ngastra kadastrale 1884-0 me sipërfaqe 25254 m². Këto ngastra përfshihen duke filluar nga udhëkryqi i rrugës Qarkore (Fabrika e Bativerive) dhe vazhdon deri te udhëkryqi i rrugës Qarkore përballë Kolegjit Gjilani, përkatësisht rrugët : “ M.Shllaku”, “A.Tahiri”, “ B. i Pavarsisë” dhe rruga” Idriz Seferi”.
- 1.19. Hapsirat për vendosjen e objekteve reklamuese-“City Lighte”, billbordeve, të cilat gjenden në ngastrat kadastrale nr.4781-0 me sipërfaqe prej 9761 m², ngastra kadastrale 2708-0 me sipërfaqe prej 12785 m², dhe ngastra kadastrale 1871-1 me sipërfaqe prej 16474 m². Këto ngastra përfshihen duke filluar nga Qendra e Qytetit, para Teatrit dhe vazhdon në drejtim të Prishtinës deri te udhëkryqi i rrugës Qarkore, përkatësisht rruga “ M.Ollbrajt” dhe “ Nëna Tereze”.
- 1.20. Hapsirat për vendosjen e objekteve reklamuese-“City Lighte”, billbordeve dhe kiosqeve të cilat gjenden në ngastrat kadastrale 2714-0 me sipërfaqe prej 13634 m² dhe 1882-0 me sipërfaqe prej 16196 m². Këto ngastra përfshihen duke filluar nga Xhamia e Deremahallës deri te fshati Velekincë, përkatësisht rrugët ” E.Berisha”, “L.e Prizerenit” dhe “Xheladin Kurbaliu”.
- 1.21. Hapsirat për vendosjen e objekteve reklamuese-“City Lighte”, billbordeve , të cilat gjenden në ngastrat kadastrale 2709-1 me sipërfaqe prej 5844 m², ngastra kadastrale 1873-0 me sipërfaqe prej 10140 m², ngastra kadastrale 1874-0 me sipërfaqe prej 12747 m², dhe ngastra kadastrale 2366-0 me sipërfaqe prej 1761 m². Këto ngastra përfshihen duke filluar nga udhëkryqi i Rr.Prishtinës (Nëna Tereze), vazhdon rrugës “P.Ahmeti” deri te rruga Qarkore në drejtim të L.të Epërm dhe segmenti i rrugës “F.Jakupi” nga ish “Vetëshërbimi Pireva” deri te rruga Qarkore.
- 1.22. Hapsirat për vendosjen e objekteve reklamuese-“City Lighte”, billbordeve, të cilat gjenden në ngastrat kadastrale 2439-0, me sipërfaqe prej 8144 m², ngastra kadastrale 2437-1 me sipërfaqe prej 1142 m², dhe ngastra kadastrale 2464-1 me sipërfaqe prej 1564 m², ngastra kadastrale 2464-2 me sipërfaqe prej 2467m², ngastra kadastrale 2464-2 me sipërfaqe prej 2203m², ngastra kadastrale 2464-4 me sipërfaqe prej 80m². Këto ngastra përfshihen duke filluar nga udhëkryqi përballë Spitalit Rajonal, vazhdon Rrugës “ Xh.Sereqi” deri te rrethrotullimi të Çerdhja e Fëmijëve “INTEGJ”.

- 1.23. Hapsirat për vendosjen e objekteve reklamuese-“City Lighte”, billbordeve, të cilat gjenden në ngastrat kadastrale 2708-0, me sipërfaqe prej 12785 m², ngastra kadastrale 4776-0 me sipërfaqe prej 7060 m². Këto ngastra përfshihen duke filluar nga udhëkryqi i Rr.Prishtinës (Nëna Tereze), vazhdon rrugës “15 Qershori” (Lagja Dardania). **(të definohen saktë sipërfaqet e nevojshme për vendosjen e objekteve reklamuese në ngastrat kadastrale të cekura nga pika 1.18 e deri në pikën 1.23 të këtij vendimi).**
- 1.24. Hapësira afër Postës së Vogël (Kioska), ngastra kadastrale 3258-0 me sipërfaqe prej 9206 m². Kjo ngastër gjinden në rrugën “ Haqif Tetova”. **(të definohet saktë sipërfaqja e kioskut i cili është i vendosur në këtë ngastër kadastrale)**
- 1.25. Hapsirat për vendosjen e objekteve reklamuese-“City Lighte”, billbordeve, të cilat gjenden në ngastrën kadastrale 4767-0, me sipërfaqe prej 14122 m². Kjo ngastër përfshin rrugën “A.Jashari” (nga Xhamia e Madhe) dhe rrugën “Z.Shemsiu” deri te Universiteti Publik i Gjilanit. **(të definohen saktë sipërfaqet e nevojshme për vendosjen e objekteve reklamuese në ngastrën kadastrale të cekur në këtë pikë).**
2. Dhënia e pronave në shfrytëzim sipas këtij vendimi bazohet në ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, rritjes së vlerës së pronës publike komunale dhe ruajtjes së mjedisit.
3. Sipas pikës 1 të këtij vendimi pronat jepen në shfrytëzim në afat prej ____ nëpërmjet ankandit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës datë 21.10.2013.
4. Procedurën e ankandit publik e udhëheq komisioni vlerësues i cili aprovohet nga Kuvendi I Komunës.
5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike që t’i definojnë saktë sipërfaqet e dedikuara për dhënien në shfrytëzim para se Komisioni Vlerësues ta bënë Shpalljen Publike për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim përmes procedurave të ankandit publik dhe ta ndihmojë komisionin në pregaditjen e procedurave të ankandit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa monitorim e zbatimit të tij e bënë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.
7. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi pushojnë të vlejnjë të gjitha vendimet e mëhershme, kontratat si dhe marrëveshjet lidhur me dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave të cilat janë objekt i këtij vendimi.
8. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Nr. 01. 016-32289
Gjilan, më 19.03.2014

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku-Rexhepi